



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI

Nr. 278 Prot.

Tiranë, më 08.02.2019

VENDIM

Nr. 9 datë 08.02 2019

MBI

MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE
PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Në zbatim të neneve 23,38,74,76 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-te e Republikës së Shqipërisë", në Rregulloren e UST-së neni 14 pika aa; si dhe në bazuar në shkresën nr. 329 prot, dt. 15.01.2019 "Për publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2020-2021", Senati me Vendim Qarkullues

V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve me kohë të plotë në programet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë për vitin akademik 2020-2021, pranë FSHL dhe FVFR.

III. FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

A. Për ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Shkencat e Lëvizjes".

1. Do të pranohen në ciklin e parë të studimeve "**Bachelor**" të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm e të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare sipas VKM Nr. 407, dt. 01/06/2016.
2. Kandidatët janë të detyruar t'i nënshtrohen konkurimit praktik sipas testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen Web të UST.

3. Kanë të drejtë të konkurojnë vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore të miratuar nga UST-ja dhe të shpallur në Web të UST-së.

B. Për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional”, “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”.

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “**Master Profesional**” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “**Bachelor**” pranë FSHL- apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen Web të UST-së.
3. Kriteri bazë do të jetë ai i notës mesatare.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar ciklin “**Bachelor**” në sistemin Full – Time dhe Part – Time pranë FSHL-së.
5. Në rast se do të rezultojnë vende të mbetura bosh do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “**Bachelor**” në IAL-ët e tjera brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare sipas rendit zbritës.

C. Për ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “**Master Shkencor**” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “**Bachelor**” pranë FSHL-së apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “**Master Shkencor**” kandidatët që kanë përfunduar me sukses mbrojtjen e një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1 sipas shkresës nr. 3228 Prot, dt. 23.03.2018 të MASR.
3. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen Web të UST.
4. Kriteri bazë do të jetë ai i notës mesatare.

II. FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

A. Për Ciklin e I-rë Bachelor “Shkencat e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit”

1. Kanë të drejtë të pranohen në programin e studimit të Ciklit të I Bachelor “Fushat e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas VKM Nr.407, datë 01.06.2016.
2. Kandidatët i nënshtrohen konkurimit praktik konform testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen web të UST.
3. Raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe mesatares së kandidatit të jetë 70% me 30%. Për kandidatët që konkurojnë për të hyrë në Ciklin e I-rë Bachelor, duhet që të grumbullojnë minimum 12 (dymbëdhjetë) pikë nga 70 (shtatëdhjetë) të mundshme të konkurimit praktik.
4. Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen web të saj.

B. Për Ciklin e II-të Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e Ciklit të II të studimeve Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në Ciklin I Bachelor pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare më të lartë.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar Ciklin e I Bachelor në sistemin me kohë të plotë dhe part time të FVFR.

5. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses Ciklin I-rë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare më të lartë.

C. Për Ciklin e II-të Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e Ciklit të II Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në Ciklin I-rë Bachelor pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Kanë të drejtë të konkurojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet në shkencat e menaxhimit dhe ato ekonomike apo në IAL-të ngjashme me to, bazuar në ekuivalentimin e krediteve.
3. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve të shpallura në faqen web të UST.
4. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare më të lartë.
5. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar studimet pranë FVFR në Ciklin I Bachelor (me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme).
6. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses Ciklin I-rë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare më të lartë.

D. Për Ciklin e II-të Master Shkencor “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e Ciklit të II Master Shkencor “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në Ciklin I-rë Bachelor pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve të shpallura në faqen web të UST.

3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare më të lartë.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar Ciklin e I Bachelor në sistemin me kohë të plotë dhe part time të FVFR.
5. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses Ciklin I-rë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare më të lartë.
6. Do të pranohen kandidatët të cilët kanë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja në programet e njohura nga MASR.

- Një kopje e këtij vendimi përcillet në MASR dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Matura Shtetërore 2020

@matura.shteterore

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron Cuka

